

RAST STUDIMOR

MBI PROCEDURËN

PËR DHËNIEN E KONCESIONIT/PARTNERITETIT
PUBLIK PRIVAT PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT
LABORATORIK TË SPITALEVE UNIVERSITARE,
RAJONALE DHE ATYRE BASHKIAKE

PROJEKTI I LABORATORËVE

KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT

ALBANIAN INSTITUTE OF SCIENCE AIS

Tiranë - Shqipëri

PARASHTRIM

Objekti i këtij rasti studimor është procedura e koncesionit/ppp e realizuar nga Ministria e Shëndetësisë me objekt: *“Për dhënien e Koncesionit/Partneritetit Publik Privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjes”*.

Ky Rast Studimor, është realizuar si pjesë e aktiviteteve të projektit me titull *“Improvement of Integrity of the Public Contractor. Legislation; Practice and Role of civic Actor”*. Një komponent i projektit është edhe fuqizimi i medias investigative dhe aktorëve civil, që monitorojnë procese të kontraktimit publik me fokus çështje që lidhen me integritetin e kontraktorëve privat.

Projekti i Laboratorëve daton nga muaji Tetor 2015 dhe është realizuar nga Ministria e Shëndetësisë. Qëllimi i realizimit të këtij Rasti Studimor është verifikimi i zbatimit të procedurave ligjore nga Autoriteti Kontraktues në hartimin e studimit të fizibilitetit, përzgjedhjen e projektit PPP si më të leverdisshëm ekonomikisht në raport me metodën tradicionale të prokurimit publik, hartimin e kriterëve të kualifikimit, sigurimin e konkurueshmërisë së operatorëve ekonomikë dhe vlerësimin e integritetit të operatorëve ekonomikë fitues në këtë garë koncesionare.

Metodologjia e ndjekur për realizimin e këtij Rasti Studimor konsiston në analizën e detajuar të elementëve të procedurës si më poshtë:

1) Analizë mbi veprimet e Autoritetit Kontraktues lidhur me identifikimin e projektit koncesionar përfshirë hartimin e studimit të fizibilitetit dhe paraqitjen pranë autoritetit kontraktues;

2) Analizë mbi veprimet e Autoritetit Kontraktues lidhur me trajtimin e studimit të fizibilitetit (bonusin e akorduar për operatorin ekonomik propozues të studimit të fizibilitetit) dhe adoptimin e përshtatjen e këtij studimi sipas parashikimeve ligjore për tu hedhur në garë;

3) Analizë mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me hartimin e dokumentave të procedurës konkurruese, përfshirë hartimin e termave të referencës dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit;

4) Analizë mbi vendimarrjen e Autoritetit Kontraktues lidhur me përzgjedhjen e fituesit të procedurës koncesionare;

5) Analizë mbi operatorin/bashkimin e operatorëve të përzgjedhur nga Autoriteti Kontraktues si fitues i kësaj procedure dhe disa aspekte të veçanta lidhur me negociimin e kontratës koncesionare;

6) Kronologjia e Veprimeve të Autoritetit Kontraktues.

SHKURTIME

Autoriteti Kontraktues – AK;

Ministria e Shëndetësisë – MSH;

International Financial Cooperation – IFC;

Studim Fizibiliteti – SF;

Dokumenta Standarde të Procedurës Konkurruese – DSPK;

Operator Ekonomik – OE;

Bashkim i Operatorëve Ekonomikë – BOE;

Partneritet Publik Privat – PPP;

Komisioni i Dhënies së Koncesionit – KDHK;

1) IDENTIFIKIMI I PROJEKTIT KONCESIONAR

Në Dhjetor të vitit 2015, Ministria e Shëndetësisë në kontekstin e reformës së saj për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve shëndetësore, ka vendosur të studiojë përmirësimin e shërbimeve të saj laboratorike përmes pjesëmarrjes së sektorit privat. Në këtë kontekst, MSH ka hartuar një Studim Fizibiliteti lidhur me Projektin e Pjesëmarrjes së Sektorit Privat në rrjetin Laboratorik Shqipëri. Në hartimin e Studimit të Fizibilitetit, MSH ka kontraktuar Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC), një anëtare e Grupit të Bankës Botërore (GBB), për të ofruar këshilla për zhvillimin e këtij projekti shëndetësor në një Partneritet Publik Privat (PPP).

Referuar sa mësipër, si dhe në kontekstin e Ligjit nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, duke qenë se Studimi i Fizibilitetit është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë, i cili në përfundim të tij ka rekomanduar Dhënien e shërbimit Laboratorik me Koncesion/PPP, rezulton se kemi të bëjmë me një **Propozim të Kërkuar nga Autoriteti Kontraktues – MSH.**

2) ANALIZA E VEPRIMEVE TË AUTORITETIT KONTRAKTUES LIDHUR ME TRAJTIMIN E STUDIMIT TË FIZIBILITETIT

Nga analiza e Studimit të Fizibilitetit të hartuar nga Autoritetit Kontraktues rezulton se veprimet kryesore për hartimin e SF konsistojnë në:

- a) Nevoja për projektin: Statusi aktual i laboratorëve të spitaleve publikë në Shqipëri

Me ndihmën e ekspertëve të përzgjedhur nga Korporata Financiare Ndërkombëtare, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar 18 laboratorë të spitaleve publike, duke përdorur një instrument vlerësimi të bazuar në standardet dhe metodologjinë SafeCare. Gjithashtu janë vlerësuar edhe 5 laboratorët më të mëdhenj privatë.

Rezultatet e vlerësimit

Vlerësimi tregon dallime të mëdha në rezultate ndërmjet laboratorëve të vlerësuar, me zona të identifikuar të kërkuara për përmirësime bazuar në standardet ndërkombëtare të cilësisë. Në përgjithësi, laboratorët e mëdhenj privatë u gjetën që ishin të pajisur më mirë dhe personel më efikas se sa laboratorët publikë. Megjithatë, laboratorët privatë gjithashtu përballen me probleme të cilësisë si një rezultat, ndërmjet të tjerave, i mungesës së matjeve strukturore të treguesve të cilësisë dhe sigurisë, bazuar në standarde të miratuar.

Gjetjet kryesore të spitaleve publike ishin:

1. Menaxhimi i shërbimeve Kërkesa të përshtatshme arsimore, por arsimim të kufizuar të vazhdueshëm për teknikët e laboratorit, Personel i tepërt, pjesërisht për shkak të pajisjeve të vjetruara laboratorike, Proces referimi i paqartë;

2. Infrastruktura dhe Paisjet Infrastrukturë e Papërshtatshme; Paisje të vjetruara; Nuk ka proces të rregullt mirëmbajtjeje & kalibrim pajisjesh

3. Reagentët, Kimikatet dhe Kitet Prokurimi i reagentëve: prokurim i decentralizuar dhe mungesa në inventar; Magazinimi i duhur i reagentëve, kimikateve dhe kiteve.

4. Menaxhimi i mostrave dhe rezultateve Gamë shumë e kufizuar e analizave kryhet në spitalet publike; Dokumentin manual i dobët i rezultateve: rreziqe të shumtë për gabime; Nuk ka Sistem Menaxhimi Cilësie të dokumentuar

5. Kërcënim serioz për kujdesin e përgjithshëm për pacientët: nuk ka kontroll cilësie; Kontrolli i brendshëm i cilësisë (IQC); Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë (EQA)

6. Çështje serioze të lidhura me Menaxhimin e Mbetjeve dhe Shëndeti & Siguria në Punë; Menaxhimi i Mbetjeve, Prodhimi dhe Ndarja e Mbetjeve Magazinimi, trajtimi, eliminimi dhe transportimi i Mbetjeve Laboratorike; Menaxhimi i Ujërave të Mbetura Laboratorike; Shëndeti dhe siguria në punë Vetë-vlerësimi i Laboratorëve

Gjetjet kryesore të Laboratorëve Privatë ishin:

Sektor aktiv i laboratorëve private; Dallimi i përgjithshëm ndërmjet ofruesve të shërbimeve laboratorike private; Rregullim i dobët; Nuk ka rrjete të laboratorëve private; Stimuj të mbrapshtë (mjekët që punojnë në laboratorë shtetërorë dhe private orientojnë pacientët drejt privatit); Përzgjedhëse (Si rezultat i rregullimeve të kufizuara, ofrimi i shërbimit laboratorik privat mbetet kryesisht i kufizuar në zgjedhjen e më të mirës, ku qeveria nuk përfiton në mënyrë efektive nga ekspertiza dhe novacionet e sektorit privat për të krijuar efikasitet dhe përmirësuar aksesin dhe cilësinë; Shpenzime të mëdha nga xhepi (Shërbimet e laboratorëve privatë nuk mbulojnë nga skema e Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor.); Infrastrukturë, pajisje dhe personel i përshtatshëm; Pikëzimi bazuar në standardet ndërkombëtare të cilësisë; Vëllime të konsiderueshme të analizave të kryera në spitale private; Paketa (Të gjithë laboratorët privatë të vëzhguar ofrojnë paketat standarde laboratorike) (shiko dok studim fizibiliteti, fq. 7 – MSH).

- b) Pas kryerjes së veprimeve paraprake të sipërcituara, nga ana e AK me ndihmën e konsulentit IFC janë ndërmarrë hapat e mëposhtëm të cilat konsistojnë në:
 - Analiza e kërkesës aktuale për shërbimet laboratorike të spitaleve publikë; (shiko dok studim fizibiliteti, fq. 16 – MSH)
 - Referenca ndërkombëtare (qasja nga poshtë lart) (shiko dok studim fizibiliteti, fq. 19 – MSH);
 - Marrja në konsideratë e kontekstit të reformave të shëndetësisë (shiko dok studim fizibiliteti, fq. 20 – MSH);
 - Parashikimi i kërkesës për shërbime laboratorike (shiko dok studim fizibiliteti, fq. 21 – MSH);
- c) Më pas ka vijuar me përshkrimin e projektit duke dhënë një panoramë të riorganizimit të laboratorëve të spitaleve publikë, bazuar në shembujt ndërkombëtarë të PPP të laboratorëve spitalorë publikë (shiko dok studim fizibiliteti, fq. 21-24 – MSH).

Pasi ka analizuar disa modele duke identifikuar rrisqet përkatëse dhe alokomin e tyre palës që mund ta menaxhojë më mirë riskun, si dhe pas ka bërë një analizë teknike e financiare të projektit të riorganizimit të laboratorëve në republikën e Shqipërisë, AK ka arritur në përfundimin se: Mbështetur në sa më sipër, mund të thuhet me një shkallë relative sigurie se Projekti i Laboratorëve në Shqipëri mund të pritet me të drejtë të sigurojë vlerë për paratë e shpenzuara për Qeverinë në rast se do të zbatohet në bazë PPP-je (shiko dok studim fizibiliteti, fq. 83 – MSH).

AK ka vlerësuar se:

Objektivi i këtij projekti është përmirësimi i shërbimit laboratorik publik në Shqipëri, duke tërhequr një partner privat për të strukturuar dhe operuar një rrjet me një nivel të laboratorëve publike, për të investuar në infrastrukturën laboratorike dhe në teknologjinë e informacionit, për të ngritur një sistem të menaxhimit të cilësisë, duke propozuar çmime të barasvlershme me ato të homologëve në rajon.

Rrjeti i laboratorëve në ambientet e spitaleve publike, përfshin një laborator qendror në Tiranë, 6 laboratorë standard qarku dhe 11 laboratorë urgjence në spitale. Kombinimi përfundimtar i laboratorëve dhe i vendndodhjes së tyre i lihet në dorë ofertuesit, që ta sugjerojë si pjesë të Ofertës së tij.

Parashikohet modeli i të ashtuquajturit rrjet me një nivel. Ai synohet të optimizojë shërbimin ndaj pacientëve, të rrisë aksesin në shërbime laboratorike të cilësisë së parë dhe të grupojë burimet për të ulur nivelin e investimit të nevojshëm për t'i shërbyer popullsisë.

Në praktikë kjo do të thotë që:

Një paketë laboratorike për analizat urgjente do të mbetet e disponueshme në të gjitha spitalet. Kjo paketë përfshin analizat laboratorike që duhet të kryhen brenda një harku të shkurtër kohor, ndaj nuk mund të çohen në laboratorin qendror;

Një paketë analizash standarde/të ndërmjetme, përfshirë analizat urgjente, do të ofrohet në laboratorët standard spitalor që ndodhen në rrethet kryesore;

Pjesa tjetër, analizat e specializuara dhe të sofistikuar të listës së referencës të analizave laboratorike do të bëhen në një laborator qendror (shiko dok studim fizibiliteti, fq.24 – MSH).

LISTA E SPITALEVE

(1) Spitali Universitar “Nënë Tereza”; (2) Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”; (3) Spitali Universitar i Traumës; (4) Spitali Universitar “Koço Gliozheni”; (5) Spitali Universitar “Mbretëresha Geraldinë”; (6) Spitali Rajonal Durrës; (7) Spitali Rajonal Berat; (8) Spitali Rajonal Fier; (9) Spitali Rajonal Vlorë; (10) Spitali Rajonal Shkodër; (11) Spitali Rajonal Elbasan; (12) Spitali Rajonal Korçë,

(13) Spitali Rajonal Gjirokastrë; (14) Spitali Rajonal Dibër; (15) Spitali Rajonal Kukës; (16) Spitali Rajonal Lezhë; (17) Spitali Lushnje; (18) Spitali Sarandë (shiko dok DSPK Shtojca 23 – MSH).

Opinion i ekspertit mbi hartimin e studimit të fizibilitetit:

- 1)** Vërejtje dhe shqetësimi kryesor lidhur me studimin e fizibilitetit të hartuar nga AK është: mungesa e krahasimit të Modelit PPP me prokurimin publik, nga ku lerverdshmëria e prokurimit Publik në raport me projektin PPP do të lejonte zhvillimin e këtij të fundi, dhe kjo në fakt është kusht ligjor i cili i detyrueshën për t'u marrë në analizë nga ana e AK. Ky parashikim ligjor mbështetet në:
 - a) Nenin 19 “*Studimi i fizibilitetit të koncesionit/partneritetit publik privat*” pika 3 të Ligjit nr. 125/2013 “*Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat*” parashikohet se: “Në studimin e fizibilitetit merren parasysh në veçanti interesi publik, ndikimi në mjedis dhe mbrojtja e mjedisit, qëndrueshmëria, përshtatshmëria financiare e projektit, treguesit e vlerës së parasë, harmonizimi i projektit me objektivat kombëtarë dhe sektorialë strategjikë, risqet direkte dhe indirekte financiare dhe ndikimet në buxhetin qendror dhe në atë të qeverisjes vendore, mbështetja e nevojshme financiare, realizueshmëria teknike dhe tregtare, si dhe interesi i tregut dhe aftësia për të tërhequr operatorët e interesuar ekonomikë dhe mbështetësit financiarë”.
 - b) Në nenin 4 “*Studimi i fizibilitetit*”, pika 2 të VKM nr 575 10.7.2013 parashikohet se: “Në studimin e fizibilitetit, ku do të detajohet informacioni i përfshirë në raportin përmbledhës, përcaktohen veçoritë kryesore të projektit, bazuar në analizën teknike, ekonomike e financiare, analizën e ndikimit mjedisor e social, si dhe në analizimin e faktit nëse projekti i hartuar si një koncesion/PPP është ekonomikisht më i favorshëm, krahasuar me alternativën e prokurimit tradicional”;

- c) Më tej akoma, në nenin 8 “Arsyetimi i vendimit të koncesionit/PPP” në pikat 1 dhe 7 parashikohet se: Neni 8 Pika 1: “Nëse është konfirmuar leverdia dhe qëndrueshmëria e projektit sipas analizave të ndërmarra në përputhje me nenet 3 deri 7, komisioni i koncesionit/PPP vazhdon me arsyetimin e vendimit për të përcaktuar nëse forma koncesion/PPP duket si modeli më i përshtatshëm për zbatimin e projektit”;
- Neni 8 pika 7: “Nëse krahasimi mes alternativës së prokurimit publik dhe alternativës së koncesion/PPPsë tregon se zgjidhja e dytë ofron vlerën më të mirë të parasë, autoriteti kontraktues mund të marrë vendimin për të përgatitur procedurën e dhënies së një kontrate me koncesion/PPP. Në qoftë se krahasimi midis alternativës së prokurimit publik dhe alternativës së koncesion/PPP-së tregon se zgjidhja e dytë nuk ofron vlerën më të mirë të parasë, atëherë autoriteti kontraktues rishqyrton mundësinë për të realizuar projektin duke përdorur alternativën e prokurimit publik”.

Referuar SF dhe konkretisht në pikën 12.2 të studimit, parashikohet se nga ana e AK, me sugjerimin e Këshilltarit IFC ky kriter ligjor thelbësor, nuk është marrë në konsideratë. Më konkretisht, SF lidhur me këtë komponent ka vlerësuar se: “Përputhshmëria e Projektit me përkufizimin e dytë, që duhet “të ofrojë një përkufizim neto krahasuar me procedurën e prokurimit publik për të njëjtin projekt specifik”, zakonisht analizohet përmes përdorimit të një ushtrimi sasior të quajtur Krahasuesi i Sektorit Publik (KSP). KSP krahason kostot e projektit dhe të ardhurat nga i njëjti projekt i zbatuar në dy skenarë të ndryshëm zhvillimi: prokurim publik përkundrejt prokurimit PPP. Megjithatë, për shkak se ka shumë probleme me metodologjinë KSP, veçanërisht kur projekte të ngjashëm nuk janë zbatuar në vend, përdorimi i qasjes sasiorë nuk rekomandohet në rastin e Projektit të Laboratorëve të Shqipërisë”. Pasi ka renditur disa arsye specifike si a) krahasimi i skenarëve hipotetikë; b) mungon kostimi i ciklit të jetës së plotë etj, dhe c) KSP mbështetet në supozime që nuk mund të provohen, konsulentit IFC ka rekomanduar që në fazat fillestare të vlerësimit të projektit, duhet të merret parasysh një qasje cilësore për analizën e vlerës së parasë në vend të KSP, veçanërisht kur nuk ekziston një aktivitet publik i krahasueshëm me të dhëna të mjaftueshme historike (shiko dok studim fizibiliteti, fq.80 – MSH).

Bazuar në parashikimet ligjore të sipërcituara, si dhe referuar faktit që AK - Ministria e Shëndetësisë nuk e ka marrë në konsideratë e për rrjedhojë nuk e ka ezauruar detyrimin ligjor të krahasimit të Modelit PPP me prokurimin publik, nga ku leverdishmëria e projektit PPP në raport me prokurimin Publik do të lejonte zhvillimin e këtij të fundi, vlerësoj se një nga kushtet kyçe ligjore të detyrueshme për t’u marrë në analizë nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk është përmbushur.

- 2)** Nga studimi i fizibilitetit rezulton e paqartë vlera ekonomike e projektit, pasi vetë autoriteti AK në pjesën e fundit të SF “Rekomandim final” ((shiko dok studim fizibiliteti, fq.86 – MSH) ka konkluduar se:

Për shkak të padisponueshmërisë të të dhënave të besueshme, nuk është e mundur të parashikohen të ardhurat bazuar në numrin e analizave të kryera. Struktura e rekomanduar e të ardhurave reflekton mungesën e një informacioni të shëndetshëm mbi vëllimet.

- një e ardhur mujore minimale e garantuar,

- një pagesë mujore bazuar në një faturë që rakordon të ardhurat për analizat e kryera, deri në 2 tavane mujore (një tavan për pacientët e shtruar, një tavan për shërbimet ambulatorë)dhe

- të ardhurat private nga pacientët e pasiguruar dhe analizat e pambuluara nga Fondi, në bazë të pagesave nga xhepi.

Analiza financiare konkludon që projekti mund të jetë si i përballueshëm për Autoritetin Publik ashtu dhe tërheqës për investitorë të mundshëm privatë, sipas këtyre kushteve. Vetëm rezultatet faktike të tenderit mund të konfirmojnë këtë konkluzion paraprak.

Rekomandohet të përcaktohen buxhete maksimale mujore për të shtruarit dhe ambulatorët në Lek, për çdo spital. Variabëli i korrigjimit do të jetë niveli i shërbimeve për pacientët ambulatorë: nëse buxheti mujor nuk mbulon të gjithë kërkesat, pacientët ambulatorë me kërkesa jo urgjente do të kenë mundësi zgjedhjeje për të paguar shërbimet nga xhepi apo t'i shtyjnë ato për muajin pasardhës.

Opinion i ekspertit mbi përlllogaritjen e vlerës së projektit:

Në nenin 20 “Llogaritja e vlerës së koncesionit/partneritetit publik privat” të Ligjit nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat” parashikohet se:

- 1. Autoriteti kontraktues llogarit vlerën e parashikuar të koncesionit/partneritetit publik privat si vlerë totale e objektit të koncesionit/partneritetit publik privat, duke përfshirë të gjitha ndryshimet e mundshme dhe opsionet e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, pa vlerën e TVSH-së.*
- 2. Vlera e parashikuar e koncesionit llogaritet në bazë të të dhënave që përmban studimi i fizibilitetit përkatës ose analiza e përmbledhur e dhënies së koncesionit.*
- 3. Vlera e parashikuar e partneritetit publik privat llogaritet sipas përcaktimeve në legjislacionin e prokurimit publik.*

Referuar bazës ligjore të sipërcituar, si dhe bazuar në shqyrtimin e studimit të fizibilitetit, rezulton se: Vlera e Kontratës (Projektit) në shumën 13,005,966,000 lekë pa TVSH (trembëdhjetë miliardë e pesë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë), e cila është publikuar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës, nuk ka një referencë të analizës financiare të mbështetur në elementë teknike, sasiorë apo statistikorë të shërbimit laboratorik. Bazuar në sa mësipër rezulton se ky parashikim ligjor nuk është ezauruar.

- 3)** Referuar SF rezulton se pritet një reduktim i numrit të punonjësve të laboratorëve ekzistues nga 504 në 390 punonjës, pra kemi një ndikim social që rrjedh nga implementimi i këtij projekti. Studimi i fizibilitetit nuk ka sqaruar në mënyrë shteruese se çfarë zgjidhje alternative do të reduktonin këtë impakt social. Në nenin 4 “Studimi i fizibilitetit”, pika 2 të VKM nr 575 10.7.2013 parashikohet se: “Në studimin e fizibilitetit, ku do të detajohet informacioni i përfshirë në raportin përmbledhës, përcaktohen veçoritë kryesore të projektit, bazuar në analizën teknike, ekonomike e financiare, analizën e ndikimit mjedisor e social, si dhe në analizimin e faktit nëse projekti i hartuar si një koncesion/PPP është ekonomikisht më i favorshëm, krahasuar me alternativën e prokurimit tradicional” çka do të thotë se Autoriteti kontraktues e ka detyrimin ligjor që të analizojë dhe paraqesë disa zgjidhjet apo opsione me qëllim reduktimin e ndikimit social të projektit PPP;

Po kështu, referuar kontratës së lidhur midis palëve, në pikën 15 të saj rezulton se pala koncesionare ka të drejtën e përzgjedhjes dhe rekrutimit të stafit në diskrecionin e saj të plotë, ndërsa autoriteti kontraktor angazhohet të ofrojë mundësi punësimi alternativ e në pamundësi të ofrimit të kësaj mundësie angazhohet të zbatojë detyrimet e Kodit të Punës kur të kryejë shkurtimet. Më tej akoma, në shtojcën 5 të kontratës *Plani i Rekrutimit*, parashikohet se në vitin e I-rë koncesionari do të punësojë 380 punonjës nga 504 ekzistues.

Opinion i ekspertit mbi ndikimin social të projektit:

Referuar studimit të fizibilitetit, si dhe kontratës së nënshkruar midis palëve, rezulton se angazhimi i Autoritetit Kontraktor lidhur me reduktimin e impaktit social të këtij projekti ka dështuar. Fare mirë, në implementimin e këtij projekti Autoriteti Kontraktor mund të merrte në konsideratë variantin e punësimit të stafit ekzistues pranë koncesionarit për një periudhë prej 1-3 vjet, e shoqëruar ndërkohë me hartimin e një plani alternativ punësimi. Një praktikë e ngjashme është ndjekur nga QSUT në privatizimin e shërbimit të Ushqimit dhe Lavanterisë në vitet 2006-2007, ku në studimet e kryera u parashikua dhe u vu si detyrim kontraktual punësimi i stafit ekzistues për një periudhë jo më pak se 1 vit edhe pse kohëzgjatja e kontratave të shërbimit ishte 4- vjet.

- 4)** Referuar Studimit të Fizibilitetit rezulton se në të gjitha referencat ndërkombëtare që janë marrë si shembuj: Mbretëri e Bashkuar, Gjermani, Rumani apo Indi, zhvillimi i projekteve PPP është bërë për një ose disa spitale Universitare, ndërkohë që PPP e laboratorëve në Shqipëri synon disa 18 laboratorë të Spitaleve Universitare, dhe spitaleve rajonale që zenë rreth 75 % të gjithë rrjetit të Laboratorëve Publikë.

Opinion i ekspertit mbi referencat ndërkombëtare:

Referuar praktikave ndërkombëtare vlerësoj se do të ishte veprim i matur (me nivel rrishtu të kontrolluar) nëse do të implementohej projekti PPP i laboratorëve për një apo disa spitale universitare dhe rajonale, në mënyrë që të shihej ecuria (suksesi apo dështimi), e në këtë mënyrë në një rast dështimi të PPP, të mos dështonte 75 % e tregut Publik të laboratorëve çka do të ishte katastrofë shëndetësore.

3) VENDIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR HARTIMIN E DOKUMENTAVE TË PROCEDURËS KONKURRUESE, PËRFSHIRË HARTIMIN E TERMAVE TË REFERENCËS DHE KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT;

Me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr.417 datë 2.10.2015 “Për ngritjen e komisionit të dhënies së koncesionit/partneritetit Publik Privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës”, është ngritur Komisioni i koncesionit/PPP me 1 Kryetar dhe 6 anëtarë.

Komisioni vendosi që Procedura e tenderit do të jetë “E hapur mbi kufirin e lartë monetar” dhe do të publikohet në gazeta ndërkombëtare dhe në portalin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

Gjithashtu Komisioni i Koncesionit/PPP, me ndihmën e konsulentit IFC hartoi dokumentet e tenderit dhe përcaktoi kriteret e kualifikimit dhe metodologjinë dhe kriteret e vlerësimit me pikë.

Kriteret e Kualifikimit përfshinin kryesisht:

- 1) Kriteret e Përgjithshme të kualifikimit të cilat japin informacione të përgjithshme mbi operatorët apo bashkimin e operatorëve që konkurron;
- 2) Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të cilat kryesisht ishin përmbledhur në:
 - a) Kriteret Teknike;
 - b) Kriteret Financiare;

Lidhur me Kriteret e Përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, në dokumentat standarde të tenderit parashikohet se Komisioni i Koncesionit/PPP do të vlerësonet operatorët/bashkimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës me sistemin kalon/ngel.

Vetëm Operatorët ekonomikë/bashkimet e shoqërive që plotësonin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit do të vlerësoheshin më tej sipas metodologjisë së vlerësimit dhe konkretisht:

KRITERET E VLERËSIMIT DHE METODOLOGJIA E VENDOSJES SË PIKËVE

| | |
|--|------------------|
| <i>1 Rrjeti laboratorik bashkëqendror (hub and spoke), dhe Sistemi i Informacionit Laboratorik dhe Sistemi logjistikës</i> | <i>10 pikë</i> |
| <i>2. Plani i Zbatimit të Projektit dhe Riinvestimi</i> | <i>15 pikë</i> |
| <i>3. Burimet Njerëzore dhe Plani i Trajnimit</i> | <i>10 pikë</i> |
| <i>4. Planin i Objekteve dhe Pajisjeve, qasja e mirëmbajtjes dhe strategjia e zëvendësimit gjate afatit te kontratës</i> | <i>10 pikë</i> |
| <i>5. Plani i menaxhimit të cilësisë dhe metodologjia për kryerjen e analizave</i> | <i>15 pikë.</i> |
| | TOTALI 60 |

PIKËT PËR OFERTËN FINANCIARE

Oferta financiare vlerësohet deri në 40 pikë, ku zbritja më e madhe e çmimit për testet merr pikët maksimale.

Pikët përfundimtare Rezultati i pikëve të ofertës teknike i shtohet pikëve të ofertës financiare nga ku del rezultati i pikëve totale, deri në 100 pikë.

Sigurimi i Ofertës

Në momentin e Afatit të Dorëzimit, Ofertuesit paraqesin Sigurimin e Ofertës (pra 2% e vlerës së përlllogaritur të Projektit, të përcaktuar në paragrafin 1.17.) në shumën 260,119,320 ALL (dyqind e gjashtëdhjetë milion njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e treqind e njëzet) e cila mund të konvertohet në Euro duke përdorur kursin e këmbimit ALL – EUR të publikuar nga Banka e Shqipërisë në datën e publikimit të njoftimit të kontratës.

Vlera e Kontratës (Projektit) llogaritur bazuar në mbështetjen financiare të parashikuar për gjithë kohëzgjatjen e kontratës: 13,005,966,000 ALL (trembëdhjetë miliardë e pesë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) (pa TVSH)

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit

Ofertuesi fitues përzgjidhet ndër Ofertuesit e Kualifikuar, sipas kriterëve të vlerësimit dhe metodologjisë së vendosjes së pikëve, të përcaktuar në Shtojcën 11 (Kriteret e vlerësimit dhe Metodologjia e Vendosjes së Pikëve).

Së bashku me dokumentacionin e tenderit, operatorëve ekonomikë pjesëmarrës ju vu në dispozicion informacioni i plotë teknik i laboratorëve kushtet teknike, numri i punonjësve, pajisjet mjekësore dhe gjendja teknike e tyre, si dhe Ju vu në dispozicion një Listë me analizat laboratorike me koston përkatëse, e cila përbën paketën e shërbimeve laboratorike që do të kryhen nga ofertuesit.

Procedura e konkurimit ishte parashikuar për tu zhvilluar në datë 15 shkurt 2017 por, duke qenë se pati një modifikim dokumentesh afati i dorëzimit dhe hapjes së ofertave u shty në datë 27 shkurt ora 15:00 MD.

(shiko dok DSPK dhe Njoftimi i Kontratës në sistem elektronik – MSH)

Opinion i ekspertit mbi hartimin e dokumentave standarde të tenderit:

Nga shqyrtimi i dokumentave standarde të tenderit rezulton se Komisioni i Koncesionit/PPP në vendosjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe përcaktimin e kriterit të përzgjedhjes së ofertës fituese është bazuar në Ligjin 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, Ligjin nr. 9643 “Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 575 datë 10.07.2013 “Për Miratimin e Rregullave për Vlerësimin dhe Dhënien me Koncesion/Partneritet Publik Privat” dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

4) ANALIZË MBI VENDIMARRJEN E AUTORITETIT KONTRAKTUES LIDHUR ME PËRZGJEDHJEN E FITUESIT DHE MBI OPERATORIN/BASHKIMIN E OPERATORËVE TË PROCEDURËS KONCESIONARE; (raport përmbledhës KDHK)

Nga shqyrtimi i vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mbi përzgjedhjen e fituesit të procedurës koncesionare rezulton se:

Me datë 27.02.2017 ora 15.00 janë hapur ofertat e “Koncesionit/partneritetit Publik Privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës”.

Në procedurën koncesionare kanë marrë pjesë 9 operatorë dhe bashkime operatorësh ekonomikë, nga të cilët 4 operatorë nuk kanë paraqitur asnjë dokumentacion kualifikues, një operator ekonomik nuk i lexohet oferta, ndërsa 4 operatorë të tjerë kanë paraqitur ofertë dhe dokumentacion shoqërues.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës dhe bashkimet e shoqërive pjesëmarrëse në këtë procedurë Komisioni i Koncesionit/PPP ka vendosur:

Të skualifikojë operatorët ekonomikë;

1. American Hospital – Nuk plotëson dokumentacionin kualifikues dhe nuk i lexohet oferta megjithë kërkesën për ndërhyrje në APP.

2.Montal - Pa oferte financiare dhe dokumente kualifikuese

3.Genius – Nuk plotëson dokumentacionin kualifikues

4.Fedos -Pa oferte financiare dhe dokumente kualifikuese

5.Biometric Albania- Pa oferte financiare dhe dokumente kualifikuese

6.Krijon Shpk. - Pa oferte financiare dhe dokumente kualifikuese

Të Kualifikojë bashkimet e shoqërive:

| | | |
|---|---|---|
| BOE 1.Acibadem Saglik Hizmetleri ve Ticaret A.S (%51) & 2.Acibadem Labmed Saglik Hizmetleri A.S (%49); (Turkey) | BOE 1. Intermedica center Sh.p.k (%66) & 2. Bioiatriki (Biomedicine) Sh.a (%34) Greece | BOE 1. Labopharma Sh.p.k (%41.7) & 2. Exalab France (%25) & 3. AB Laboratory Solutions B.V (%33.3) Netherland |
|---|---|---|

Gjithashtu, pasi shqyrtoi propozimin teknik dhe financiar të 3 bashkimeve të sipërcituara të operatorëve ekonomike, Komisioni i Koncesionit/PPP vendosi të vlerësojë me pikë si më poshtë:

- 1) BOE Labopharma Sh.p.k (%41.7) & Exalab France (%25) & AB Laboratory Solutions B.V (%33.3) Netherland oferta: 10.7% zbritje 98.14 pikë;

- 2) *BOE Intermedica center Sh.p.k (%66) & Bioiatriki (Biomedicine) Sh.a (%34)*
oferta: 5.700% zbritje *77.02 pikë;*
- 3) *BOE Acibadem Saglik Hizmetleri ve Ticaret A.S (%51) & Acibadem Labmed Saglik Hizmetleri A.S (%49) ; oferta: 4.80% zbritje* *65.19 pikë.*

Referuar vendimarrjes së Autoritetit Kontraktor rezulton se konsulenti IFC i autoritetit kontraktor nuk ka qenë dakord me vendimarrjen e autoritetit kontraktor për të kualifikuar BOE “Labopharma Sh.p.k & Exalab & AB Laboratory Solutions B.V”, bashkim shoqërisht i cili pas kualifikimit është vlerëzuar me pikët maksimale nga Komisioni i Koncesionit/PPP.

Më konkretisht: konsulenti IFC lidhur me kualifikimin e këtij BOE ka deklaruar se:

1. Çështje integriteti të kompanisë ABLs pra një anëtar i BOE

IFC lidhur me këtë fakt, është bazuar në dy artikuj gazetash spanjolle të cilat hedhin dyshime mbi përfaqësuesin ligjor të shareholder –it të ABLs-së (Orinoco mining&resources B.V dhe anëtarin e bordit të saj, kompaninë ITPS) i cili, sipas këtij shtypi, është në ndjekje penale në Spanjë.

Gjithashtu IFC rekomandon se UBO (ultimate beneficiary owner) i ABLs-së nuk rezulton i qartë nëse është kompania shqiptare Pegasus sh.p.k pavarësisht dokumenteve të paraqitura prej tyre.

dhe

2. Çështjen e kontrollit mes kompanive Exalab dhe Sealab të cilat marrin përsipër realizimin e testeve ku sipas IFC-së, Sealab nuk kontrollohet nga Exalab pasi nuk zotëron mbi 40% të së drejtës së votës të kjo kompani, sipas nenit L 233-3 të Kodit Tregtar francez, pika II.

Sa mësipër IFC ka rekomanduar skualifikimin e këtij BOE për arsyet e sipërcituara.

Komisioni i Koncesionit/PPP nuk e ka marrë në konsideratë opinionin e IFC lidhur me skualifikimin e “Labopharma Sh.p.k & Exalab & AB Laboratory Solutions B.V”, duke dhënë si argument:

- a) *Lidhur me arsyen e parë Komisioni i Koncesionit/PPP ka vlerësuar se ky anëtar i BOE nuk rezulton të jetë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë e për pasojë nuk ndodhemi në kushtet e ndalimit të pjesëmarrjes në tendera publikë të parashikuar në nenin 45 të Ligjit të Prokurimit Publik. Gjithashtu, Komisioni vëren gjithashtu se ky përfaqësues ligjor është zëvendësuar me datë 16.03.2017 sipas dokumenteve të paraqitura nga ky BOE.*
- b) *Lidhur me arsyen e dytë Komisioni ka vlerësuar se: “Labexa Group ka filial Sealab dhe sipas rregullores së organizimit të Labexa Group, kjo e fundit ushtron kontroll efektiv mbi Sealab ku ndërkohë Labexa dhe Exalab janë cross shareholders”*

Referuar këtij arsyetimi, Komisioni i Koncesionit/PPP ka vlerësuar të kualifikojë BOE “Labopharma Sh.p.k & Exalab & AB Laboratory Solutions B.V” dhe pas vlerësimit, ky bashkim shoqërisht është klasifikuar në vend të parë dhe shpallur fitues.

Opinionin e ekspertit mbi vendimarrjen e Autoritetit Kontraktor:

Përgjithësisht Komisioni i Koncesionit/PPP nga pikëpamja formale juridike i ka zbatuar drejt procedurat e parashikuara në Ligjin Për Koncesionet, Ligjin e Prokurimit Publik, VKM 575 (koncesionet) dhe VKM 914 (Prokurimet) deri në momentin e vlerësimit të BOE “Labopharma Sh.p.k & Exalab & AB Laboratory Solutions B.V”.

Në vendimarrjen e Komisionit të Koncesionit/PPP vlen të veçojmë vendimin për të mos marrë në konsideratë opinionin e IFC lidhur me skualifikimin e BOE “Labopharma Sh.p.k & Exalab & AB Laboratory Solutions B.V”, i cili është i shumë i diskutueshëm për arsye se:

- a) Lidhur me arsyen e parë të propozuar nga IFC për skualifikimin e BOE “Labopharma Sh.p.k & Exalab & AB Laboratory Solutions B.V”, Komisioni i Koncesionit/PPP i është referuar nenit 45 të Ligjit të Prokurimit Publik, duke vlerësuar se duhet të kemi një vendim gjykate të formës së prerë në mënyrë që të përjashtohet një ofertues nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik. Në fakt, po ky Komision ka përcaktuar në dokumentet e procedurës konkurruese shtojca 12 **VETËDEKLARIM PËR OFERTUESIT E HUAJ** se: *“Ofertuesit e huaj duhet të deklarojnë se nuk janë nën hetim penal për mashtrim, korrupsion, falsifikim ose pastrim parash në datën e dorëzimit të Ofertës dhe gjatë tre (3) viteve të fundit përpara dorëzimit të Ofertës”*; Referuar këtij parashikimi të dpk rezulton se të gjithë pjesëmarrësit në këtë procedurë kanë patur detyrim të vetëdeklarimit faktin nëse kanë qenë apo janë nën hetim për veprat e cituara në shtojcën 12 në datën e ofertës;
- b) Nga ana tjetër, Komisioni i Koncesionit/PPP edhe pse ka patur indicie nga konsulenti IFC, i Kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, nuk ka verifikuar këto indicie siç parashikohet në nenin 53/1 të Ligjit të Prokurimit Publik ku citohet se: *“Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cënuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme”*.
Në një këndvështrim korrekt ligjor, Komisioni i Koncesionit/PPP mund të vijonte me kualifikimin e BOE “Labopharma Sh.p.k & Exalab & AB Laboratory Solutions B.V” vetëm pas verifikimit të indicieve dhe fakteve dhe sqarimit të situatës së integritetit të një anëtarit të bashkimit të shoqërive. penale rezultateve negative sqarimit të
- c) Komisioni i Koncesionit/PPP në arsyetimin e tij për të mos marrë në konsideratë mendimin e konsulentit ka sqaruar gjithashtu se vendimarrjen e tij ka sqaruar se përfaqësuesi ligjor i anëtarit të bashkimit të shoqërive “ABLS” është zëvendësuar me datë 16.03.2017 sipas dokumenteve të paraqitura nga ky BOE.
Në fakt, ky veprim nuk ka efekt mbi vendimarrjen e Komisionit, pasi qartazi në shtojcën 12 të dpk parashikohet si datë reference data e dorëzimit të Ofertës dhe gjatë tre (3) viteve të fundit përpara dorëzimit të Ofertës, pra pasoja juridike për efekt vlerësimi integriteti ka ardhur e për rrjedhojë, të gjitha veprimet apo vendimet post datës së paraqitjes së ofertës nuk kanë asnjë pasojë ligjore dhe nuk mund të merren në konsideratë.

Referuar sa mësipër, edhe eksperti ligjor bashkohet me qëndrimin e konsulentit IFC për skualifikimin e BOE “Labopharma Sh.p.k & Exalab & AB Laboratory Solutions B.V”, për arsye se një nga anëtarët e këtij Bashkimi (shoqëria ABLs) nuk plotëson kriterin e Integritetit.

5) DISA ASPEKTE TË VEÇANTA LIDHUR ME NEGOCIMIN E KONTRATËS KONCESIONARE;

Nga shqyrtimi i procedurës së ndjekur nga Autoriteti kontraktor Ministria e Shëndetësisë deri në nëshkrimin e kontratës koncesionare mund të vërejmë disa aspekte dhe konkretisht:

- a) Kohëzgjatja e negociimit të kontratës.

Siç rezulton nga sa mësipër vërejmë se data e njoftimit të kualifikimit të operatorëve/bashkimit të operatorëve është publikuar në data room të APP-së në 20.03.2017. Ndërkohë që kontrata e Partneritetit publik – privat për Ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësore mban datën 10.04.2019.

Pra, palëve u është nevojitur një periudhë më shumë se dy vjeçare për negociimin e kontratës (*shiko dok kontratë nr. 1924/2 datë 10.04.2019 fq 1 – MSH*);

Opinionimi i ekspertit mbi kohëzgjatjen e negociimit:

Ligjërisht nuk ekziston ndonjë afat lidhur me negociimin e kontratës së Koncesionit/PPP me Fituesin, megjithatë, në procedurën konkrete, Autoriteti Kontraktues si në Studim Fizibiliteti ashtu edhe në dokumentet e procedurës konkurrese ka publikuar një kalendar me fazat konkrete dhe afatet përkatëse për secilën nga këto faza dhe si periudhë e nënshkrimit të kontratës është përcaktuar Muaji Maj 2017. Duke qenë se njoftimi i kualifikimit të operatorëve/bashkimit të operatorëve është bërë në datën 20 Mars 2017, fakti se periudha e negociimit të kontratës ka zgjatur 2 vjet është një indikator i faktit se palët kanë pasur vështirësi në hartimin dhe dakordësimin e marrëveshjes së koncesionit/PPP.

b) Ndryshimi i një anëtari të bashkimit të shoqërive të shpallur fitues nga Autoriteti Kontraktues:

Gjatë negociimit të kontratës, një nga anëtarët e bashkimit të shoqërive të shpallur fitues nga Autoriteti Kontraktor, dhe konkretisht shoqëria “AB Laboratory Solutions B.V” e cila ishte kontestuar nga Konsulenti IFC për çështjet e Integritetit, ka kërkuar të largohet nga bashkimi i shoqërive.

Kjo kërkesë nuk është miratuar nga Komisioni i Dhënies me Koncesion/PPP (*raport përmbledhës KDHK*).

Opinionimi i ekspertit mbi largimin e anëtarit të bashkimit të operatorëve fitues të koncesionit.

Në nenin 74, pika 5 të VKM nr 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “*Në rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me një operator tjetër ekonomik, anëtar të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti kontraktor zgjidh kontratën. Në rast se këto rrethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, atëherë detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të merren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një anëtar tjetër i bashkimit, me kusht që ky të plotësojë kërkesat*”.

Referuar në këtë parashikim ligjor, rezulton se Autoriteti Kontraktues mund të lejonte largimin e një anëtari të bashkimit të shpallur fitues, nëse anëtarët e tjerë të këtij BOE pra “Labopharma Sh.p.k & Exalab” plotësojnë kërkesat teknike, ekonomike dhe juridike të dyja së bashku sipas kërkesave të AK, në mënyrë që të garantojnë ekzekutimin me sukses të kontratës.

c) Sigurimet e Kërkuara

Referuar Kontratës në shtojcën 16 palët kanë përcaktuar Sigurimet e kërkuara dhe konkretisht:

1. GJATË FAZËS SË RINOVIMIT

- a. Sigurimin e të gjitha rreziqeve të ndërtimit (të kontrolluar nga titullari), në bazë të vlerës së plotë të kontratës, që përfshin:
- b. Opsionale: Humbjen e fitimit, pas Sigurimit të të gjitha rreziqeve të ndërtimit;

2. GJATË OPERACIONEVE NË VAZHDIM

- a. Sigurimin nga zjarri dhe nga të gjitha Rreziqet e Tjera, në bazë të kostos së zëvendësimit me asete të reja;
- b. Sigurimi i Pajisjes Elektronike për pajisjet;
- c. Sigurimi për Ndërprerje të Biznesit pas a & b;
- d. Sigurimi i Përgjegjësisë së Përgjithshme Publike;

- e. Sigurimi për Dëmshpërblim Profesional/Shpërdorim Detyre për të mbrojtur Ofruesin Privat të shërbimit dhe punëmarrësit e tij, nëse mund të nxirret sigurim me prime të arsyeshme;

3. GJATË GJITHË KOHËS

- a. Të gjitha sigurime që kërkohen nga Ligji i Zbatueshëm.

(shiko dok kontratë nr. 1924/2 datë 10.04.2019 Shtojca 16 – MSH)

Opinioni i ekspertit mbi sigurimet e kërkuara:

Nga shqyrtimi i shtojcës 16, rezulton se palët kontraktore nuk e kanë përfshirë “Sigurimin e Përgjegjësisë Profesionale”. Sigurimi i Përgjegjësisë profesionale ofrohet për të mbuluar të siguruarin në rast dëmtimesh që ai i shkakton shëndetit ose pronës së të tretëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij. Në fakt nisur nga natyra e projektit koncesionar ku rezulton se ai bart rrisqe profesionale karshi të tretëve, përfshirja e këtij lloj sigurimi në kontratë do të duhej të ishte parashikuar që në studim fizibiliteti e më pas në kontratë.

6) KRONOLOGJIA E VEPRIMEVE TË AUTORITETIT KONTRAKTUES:

1) Në datë 02.10.2015, me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 417 datë 2.10.2015 ngrihet Komisioni i dhënies së koncesionit/partneritetit Publik Privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës;

2) Autoriteti Kontraktues ka angazhuar Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC), për të ofruar këshilla për zhvillimin e këtij projekti shëndetësor në një Partneritet Publik Privat (PPP).

3) Në dhjetor 2015 është hartuar Studimi i Fizibilitetit;

4) Në 22.12.2016 publikohet shpallja e procedurës, parashikuar për tu zhvilluar në datë 15.02.2017, Për shkak të disa ndryshimeve në dokumentat e procedurës, hapja e ofertave është shtyrë për në datë 27.02.2017;

5) Kushtet kryesore të Kontratës janë:

Objekti i Kontratës: Financimi, projektimi, rinovimi, pajisja, riorganizimi dhe funksionimi i Koncesionin/Partneritetin Publik Privat për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale, dhe atyre bashkiake të Sarandës e Lushnjës.

Forma e Kontratës: Partneritet publik privat për shërbime publike;

Burimi i Financimit të Projektit: Buxheti i shtetit nëpërmjet Spitaleve subjekt i kësaj kontrate;

Afati i Kontratës së Koncesionit 10 vjet duke filluar nga Data e Vënies në Funkcion (e përcaktuar në Kontratën e Koncesionit);

Vlera e Kontratës llogaritur bazuar në mbështetjen financiare të parashikuar për gjithë kohëzgjatjen e kontratës 13,005,966,000 ALL (trembëdhjetë miliardë e pesë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) (pa TVSH);

6) Në datë 27.02.2017 janë hapur ofertat e paraqitura nga Operatorët ekonomikë nga ku rezultoi se kishin marrë pjesë gjithsej 9 operatorë dhe bashkime operatorësh ekonomikë;

- 7) Në datë 20.03.2017 është kryer vlerësimi i procedurës, nga ku rezultoi se 6 operatorë ekonomikë janë skualifikuar dhe 3 BOE janë kualifikuar dhe ka vazhduar procesi i vlerësimit me pikë.
- 8) Shoqëria fituese është shpallur Konsorciumi “Labopharma Sh.p.k & Exalab & AB Laboratory Solutions B.V” ;
- 9) Në datë 10.04.2019 është nënshkruar kontrata me nr. 1924/2 me objekt: “Për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësore” ndërmjet Autoritetit Kontraktor Ministria e Shëndetësisë dhe Bashkimit të operatorëve ekonomikë“Labopharma Sh.p.k & Exalab & AB Laboratory Solutions B.V”.;
- 10) Në datë 19.06.2019 është krijuar Subjekti për Qëllime të Vecanta (SPV) “LABORATORY NETWORKS” SH.P.K., me qëllim implementimin dhe zbatimin e Marrëveshjes së Konçesionit.

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE TË RASTIT STUDIMOR

Në përfundim të hulumtimit përmes këtij rasti studimor, konstatohet se:

- 1) Autoriteti Kontraktues - Ministria e Shëndetësisë nuk ka ezauruar një nga kushtet thelbësore të parashikuara në Ligjin dhe Rregullat për dhënie të koncesioneve/PPP dhe konkretisht: Detyrimin ligjor të krahasimit të Modelit PPP me prokurimin publik, nga ku lerverdshmëria e projektit PPP në raport me prokurimin Publik do të lejonte zhvillimin e këtij Projekti;
- 2) Autoriteti kontraktues nuk ka publikuar asnjë referencë të analizës financiare të mbështetur në elementë teknikë, sasiorë apo statistikorë të shërbimit laboratorik ku është mbështetur për të llogaritur vlerën e Projektit në shumën 13,005,966,000 lekë pa TVSH;
- 3) Implementimi i Projektit të Laboratorëve për pothuajse gjithë Territorin e Republikës së Shqipërisë, bart rrisht të shtuar për palën Publike, pasi në një situatë dështimi të projektit mund të çojë në kolaps shëndetësor sistemin Publik të laboratorëve, çka do të ishte katastrofë shëndetësore;
- 4) Angazhimi i Autoritetit Kontraktor lidhur me reduktimin e impaktit social të këtij projekti ka dështuar.
- 5) Përzgjedhja e Fituesit të Projektit është kryer në kundërshtim me kuadrin ligjor të koncesioneve/PPP, në kundërshtim me kriteret e publikuara nga Autoriteti Kontraktues, si dhe pa marrë në konsideratë Opinionin e ekspertit ndërkombëtar IFC;
- 6) Kontrata nuk parashikon një nga sigurimet kryesore të projekteve të kësaj natyre, siç është “Sigurimi i Përgjegjësisë Profesionale”.